



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 36, datë 03.03.2022**

**MBI**

**ZGJATJEN E VENDIMARRJES SË BORDIT PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË  
“LAJTHIZA INVEST” SH.A. NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE NGA HEC “QAMI 1”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1.730 MW**

Në mbështetje të neneve 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 03.03.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 322/3 prot., datë 28.02.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “LAJTHIZA INVEST” sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “QAMI 1”, me kapacitet të instaluar 1.730 MW”,

**Konstatohet se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 11, datë 21.01.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “LAJTHIZA INVEST” sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Qami 1”, në përroin e Srriqes, Satrave dhe Valës, degë të përroit të Srriqes, i cili ndodhet në anën e majtë të lumit Drin, Qarku Kukës.
- ERE me shkresën nr. 70/2 prot., datë 21.01.2022, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e procedurës dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve nga palët e treta (data 04.02.2022), nuk rezultoi të ketë patur të tilla .
- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 11/3 prot., datë 02.02.2022, nr. 11/5 prot., datë 17.02.2022 dhe nr. 11/6 prot., datë 25.02.2022, shoqëria ka depozituar dokumentacion dhe informacion, sipas kërkesave të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të Aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “LAJTHIZA INVEST” sh.a. rezulton se shoqëria ka plotësuar kryesisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:
  - Formati dhe dokumentacioni për aplikim. Neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”. **Plotësuar.**
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor. Neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, dhe “f”. **Plotësuar.**
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal. Neni 9, pika 3, gërma “a”, “b”, “c” dhe “d”. **Plotësuar.**
  - Dokumentacioni teknik për HEC. Neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3 gërma “a”, “b”, “c” dhe “d” **Plotësuar.**
  - Dokumentacioni tekniko-ekonomik. Neni 9, pika 4.1.4, gërmat “b”, “c”, “d”, “e”, “f”. **Plotësuar**
  - Leje nga institucione të tjera. Neni 9, pika 4.1.5, gërmat “a”, “b”, “c”. **Plotësuar.**
- Me qëllim sqarimin e konstatimeve në lidhje me dokumentacionin që ka të bëjë me dokumentacionin e pronës (neni 9, pika 2, gërma “g”) dhe studimin e fizibilitetit (neni 9, pika 4.1.4, gërma “g”) dhe në mbështetje të nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, vlerësohet e arsyeshme të zgjatet me 10 ditë pune vendimmarrja e bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë “LAJTHIZA INVEST” sh.a. për licencimin në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “QAMI 1”, me kapacitet të instaluar 1.730 MW.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të zgjasë me 10 (dhjetë) ditë pune vendimmarrjen e bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë “LAJTHIZA INVEST” sh.a. për licencimin në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “QAMI 1”, me kapacitet të instaluar 1.730 MW.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**